

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6824  
E hënë, 13 shkurt 2023  
çmimi 0.40

## Osmani: Wagneri po e ndihmon Serbinë të përgatisë një sulm të mundshëm ndaj Kosovës

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# MBI 33 000 VIKTIMA NGA TËRMETET, OKB-ja PRET QË NUMRI TË DYFISHOHET



Kombet e Bashkuara dënuan dështimin për t'i ndihmuar rajonet e Sirisë teksa paralajmëruan se numri i viktimave nga tërmetet në Turqi

dhe Siri, që ka arritur në mbi 33 000, mund të dyfishohet. Dhjetëra mijëra punëtorë të shpëtimit po vazhdojnë operacionet për të gjetur të

mbijetuar pavarësisht prej temperaturave të ulëta që kanë rënduar gjendjen e miliona personave që tani kanë nevojë për ndihmë

## OPINION

### GJYKATA SPECIALE, ME PRAPASKENË TË MAKINERISË MAFIOZE SERBE!

F. 6



Shkruan: Sali BISLIMI

## AKTUALE



### BALONA KINEZE ERRËSOI QIEJT DIPLOMATIKË

F. 2

### POLICIA ZBULON TRE LABORATORË DROGE NË VERI, ARRESTON DY SERBË

F. 3



## EKONOMI

### "MASHTRIMET E MËDHA" TË QEVERISË SIPAS LDK-së: SHTRENJTIM 100 PËR QIND TË ENERGJISË

F. 7

### MINISTRI MURTATI THOTË SE JANË REGJISTRUAR 1 000 VENDE PUNE NË PLATFORMËN 'SUPERPUNA'

F. 7

## SPORT



### FITOJNË BALLKANI DHE LLAPI, HUMBASIN DRITA DHE PRISHTINA

F. 10

### KURTI: PËR SHKAK TË SERBISË, KOSOVA KA HUMBUR MBI 300 MILIONË EURO

FAQE 3



### AMBASADORI WESTERLUND: KA INTERES NGA KOMPANITË SUEDEZE QË TË VIJNË NË KOSOVË

FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+389 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Balona kineze errësoi qiejt diplomatikë



WASHINGTON, 12 SHKURT - Qytetarët amerikanë për herë të parë panë një gjë të prekshme nga Kina, që e sfidon sigurinë e tyre kombëtare: një balonë gjigante të bardhë. Për disa ditë ajo fluturoi mbi qiejt e Shteteve të Bashkuara duke u bërë objekt i një kurioziteti të pafundmë nga publiku: Çfarë është? Çfarë po bën? Dhe e kujt është?

Pentagoni më pas tha se është një balonë ushtarake nga Kina që ka qëllime spiunimi dhe presidenti Joe Biden dha urdhër për rrëzimin e saj. "I thashë Departamentit të Mbrojtjes se dua ta rrëzoj sa më shpejt. Ata konstatuan se nuk duhet ta rrëzojmë mbi tokë, se nuk është një kërcënim serioz, dhe se duhet të presim derisa të kalojë mbi ujë", tha Bideni. Ministria e Jashtme e Kinës tha se balona ishte civile dhe se ishte përdorur për qëllime meteorologjike. Zëdhënësja Mao Ning tha se i vjen keq që ka hyrë "paqëllimshëm" në qiejt e ShBA-së dhe dënoi rrëzimin e saj. "Kina është një vend i përgjegjshëm. Ne gjithmonë i kemi respektuar me përpikëri ligjet ndërkombëtare dhe kemi respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial të vendeve të tjera", tha Mao. Incidenti me balonën bëri që sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ta anulonte vizitën në Pekin më 5 dhe 6 shkurt, për të cilën të dyja

vendet kishin shpresuar se do t'i qetësonte marrëdhëniet e tyre të tensionuara. "Prania e balonës kineze në hapësirën ajrore të ShBA-së është shkelje e qartë e sovranitetit të ShBA-së dhe ligjit ndërkombëtar. Është një akt i papërgjegjshëm dhe ky veprim i Kinës, në prag të vizitës sime të planifikuar, është i dëmshëm për diskutimet që i kemi planifikuar", tha Blinken. ShBA-ja dhe Kina kanë marrëdhënie të tensionuara për një varg çështjesh, si: spiunazhi, tregtia, pozicionimi ushtarak i Pekinit në Tajvan dhe abuzimet me të drejtat e ujqurëve dhe pakicave të tjera kryesisht myslimane në provincën kineze, Ksinjiang. Megjithatë, kjo nuk është hera e parë që balonat kineze kalojnë hapësirën ajrore të ShBA-së - gjatë kësaj administrate apo asaj para saj - por informacionet e tilla nuk janë bërë publike deri më tash. Vetë gjenerali i Forcës Ajrore të ShBA-së, Glen Van Herck, ka thënë se ushtria ka mësuar për ato fluturime pasi komuniteti i inteligjencës i ka mbledhur faktet dhe e ka njoftuar. Po përse kësaj here balona ka marrë vëmendje aq të madhe? Gabriel Wildau, analist i rrezikut politik nga Kina, pranë Institutit Teneo, flet për programin Expose të Radios Evropa e Lirë: "Dallimi këtë herë është se kjo balonë ka pësuar një problem teknik dhe ka fluturuar më

poshtë. Për këtë arsye, nuk ka mundur të mbahet sekret, sepse është parë nga toka, me sy të lirë. Kjo e ka detyruar administratën e Bidenit të flasë publikisht për këtë balonë dhe të zbulojë që edhe balona të tjera kanë kaluar nëpër hapësirën ajrore të ShBA-së në të kaluarën", thotë Wildau. Balonat janë një nga format më të vjetra të teknologjisë së mbikëqyrjes. Japonia, për shembull, i ka përdorur ato për të lëshuar bomba në ShBA gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ato janë përdorur edhe nga ShBA-ja dhe Bashkimi Sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë. Ekspertët thonë se Kina ka tani teknologji më të sofistikuara për mbikëqyrje. Përdorimi i balonës, sipas tyre, mund të ketë qenë një sinjal për amerikanët, apo test se si do të reagojnë. Christopher Twomey, ekspert i sigurisë në Shkollën Pasuniversitare Detare të ShBA-së në Kaliforni, shpjegon më shumë për Exposenë: "Sjellja e Kinës është bërë gjithnjë e më provokuese viteve të fundit, dhe është përqendruar me pandeminë Covid-19. [Balona] është thjesht një shembull i qartë i atyre provokimeve. Kur qytetarët amerikanë në disa shtete shikojnë kah qielli dhe shohin spiunazhin kinez... mendoj se është një shenjë shumë e fuqishme. Unë mendoj se kjo do ta pengojë administratën Biden që të

punojë me Kinën". Kina, e cila ka pësuar goditje të mëdha ekonomike nga pandemia, ka dhënë sinjale se dëshiron t'i përmirësojë marrëdhëniet me Perëndimin qysh në fund të vitit të kaluar, kur kancelari gjerman, Olaf Scholz, ka udhëtuar në Pekin dhe, më pas, kur udhëheqësi kinez, Xi Jinping, ka ofruar një mesazh bashkëpunimi në samitin e grupit të vendeve më të industrializuara, G20, në Bali. Vizita e planifikuar e Blinkenit ka pasur po ashtu këtë qëllim. Për më tepër, Kina ka ftuar në vizitë edhe sekretaren amerikane të Thesarit, Janet Yellen. Dhe fluturimi i balonës kineze në qiejt e ShBA-së duket se nuk shkon në favor të këtyre synimeve të deklaruara. Ekspertët e shpjegojnë ndryshe-ndryshe. Tong Zhao, nga Instituti Carnegie, flet për Exposenë: "Personalisht, mendoj se ka gjasa të ketë qenë një aksident. Nuk mendoj se Kina e ka lejuar qëllimisht balonën të shkelë hapësirën ajrore të ShBA-së. Një gjë e tillë bart rrezik të madh politik. Nuk mendoj se është një gjë e mençur, që politikanët ta lejojnë qëllimisht". Por, eksperti i sigurisë, Christopher Twomey, përmend disa teori të tjera të mundshme. "Ka dy shpjegime të mundshme. Ose ushtria [kineze] nuk pajtohet me vullnetin e lidhës politik për

t'i përmirësuar marrëdhëniet [me ShBA-në], ose lidhësi politik nuk ka kontroll të fortë mbi ushtrinë, sa i përket përfshirjes në këtë lloj spiunazhi. Ndoshta është rutinë për ushtrinë e Kinës që të bëjë këso lloje monitorimesh, dhe është sfiduese për Xi Jinpingun që t'i kontrollojë ato në baza ditore. Por, sido që të jetë, do të duhej të ishte shqetësuese nga këndvështrimi amerikan", thotë Twomey. Zyrtarët amerikanë nuk kanë thënë se çfarë të dhënash mund të ketë mbledhur balona kineze dhe nëse ajo ka shkaktuar ndonjë dëm në marrëdhëniet e brishta ShBA-Kinë. Por, Gabriel Wildau, nga Institutit Teneo, thotë se balona patjetër se hedh benzinë në zjarr. Se çfarë drejtimi do të marrin ngjarjet, mbetet të shihet. Mediat në ShBA kanë cituar disa zyrtarë të kenë thënë se balona kineze ka qenë e pajisur me antena të shumta, të cilat kanë pasur kapacitet të kapin sinjale komunikimi. Sipas tyre, ShBA-ja po e shqyrton marrjen e masave kundër disa grupeve të lidhura me qeverinë kineze, të cilat kanë qenë të përfshira në fluturimin e balonës. Ministria e Jashtme kineze ka thënë se të dyja palët duhet të qëndrojnë qetë. Blinken, në anën tjetër, ka thënë se do ta vizitojë Pekinin "kur ta lejojnë kushtet", por nuk ka specifikuar më shumë.

## Kurti: Për shkak të Serbisë, Kosova ka humbur mbi 300 milionë euro

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se që nga viti 1999, për shkak të veprimeve të Serbisë, Kosova ka humbur mbi 300 milionë euro nga faturat e rrymës dhe ujit që serbët në veri nuk kanë paguar. Përmes një postimi në "Twitter", Kurti tha se për mospagesën e faturave në veri nuk kanë faj serbët që jetojnë atje, por ai për këtë fajësoi "strukturat paralele të kontrolluara nga Serbia". "Që nga viti 1999 Kosova ka humbur mbi 300 milionë euro për shkak të veprimeve të Serbisë, sikurse janë mbajtja e tarifave të transmisionit dhe detyrimi i tregtarëve që të paguajnë TVSh-në të Serbia për tregtinë tonë të energjisë elektrike. Edhe tani refuzimi i Beogradit për ta lejuar tregtinë Kosovë - Serbi i kushton Kosovës deri në 10 milionë euro në muaj", ka shkruar Kurti. Sipas tij, 320 milionë euro janë humbur nga faturat e papaguara të rrymës dhe 17



milionë të tjera nga ato të ujit. Megjithatë, Kurti tha se nëse do të paguheshin këto fatura, atëherë institucionet qendrore do të mund të bënin më shumë investime në këtë pjesë që, sipas

tij, do ta përmirësonin kualitetin e shërbimeve për qytetarët. "Ata [qytetarët] kanë të drejtë të kenë qasje në shërbime të tilla dhe të jetojë të lirë nga krimi i organizuar, presioni dhe kërcënimet nga

strukturat ilegale që udhëhiqen nga Serbia. Qeveria ime është e përkushtuar që ta përmirësojë cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe t'u ofrojë atyre lirinë dhe sigurinë që e

meritojnë", ka shkruar Kurti. Qytetarët e këtyre komunave që nga viti 1999 nuk paguajnë për energjinë e shpenzuar. Përgjatë viteve, borxhi i tyre është paguar nga qytetarët e komunave të tjera të Kosovës dhe që nga viti 2017 nga Qeveria e Kosovës. Kosova dhe Serbia, në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, më 2013 kanë arritur Marrëveshje për energjinë, që synon rregullimin e çështjes së furnizimit dhe faturimit të energjisë elektrike në katër komunat në veri, të banuar me shumicë serbe. Por, kjo marrëveshje nuk është zbatuar dhe në qershor të vitit 2022, palët arritën pajtueshmëri për zbatimin e marrëveshjes ekzistuese për energjinë përmes një udhërrëfyesi për energjinë. Megjithatë, as ky udhërrëfyes nuk është zbatuar dhe gjatë vitit të kaluar, BE-ja ka pranuar se ka vonesa në zbatimin e tij, duke theksuar se përgjegjësinë përfundimtare për zbatimin e udhërrëfyesit e kanë Kosova dhe Serbia.

## Policia zbulon tre laboratorë droge në veri, arreston dy serbë



MITROVICË, 12 SHKURT - Dy serbë janë arrestuar dhe janë zbuluar tre laboratorë droge në veri të Kosovës, bëri me dije Policia e Kosovës më 12 shkurt. Policia tha se të dielën realizojë operacionin antidrogë të koduar "Shpata" në tri lokacione në rajonin e Mitrovicës veri. Sipas njoftimit, gjatë operacionit policor janë zbuluar tre laboratorë me bimë narkotike, në dy prej të cilëve u gjetën rreth 1 200 bimë narkotike, ndërsa te njëri nuk kishte bimë narkotike, por pajisje të sofistikuara për kultivimin e tyre, tha policia. "Njësitë policore deri në këtë fazë kanë arritur të arrestojnë dy persona të dyshuar meshkuj serbë, përderisa të gjitha veprimet e tjera policore në proces po ndërmerren dhe do të ndërmerren në bashkërendim me organet e drejtësisë", thuhet në njoftimin e policisë. Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha se bashkëpronar i një prej laboratorëve është D. S. që,

sipas tij, ka sulmuar Policinë e Kosovës muajin e kaluar. Ai tha se operacioni policor është realizuar në Mitrovicë të Veriut. "Ai është pjesë e bandave që marrin urdhra nga krimi i organizuar në Serbi. Ata që mbështeten dhe mbrohen nga [presidenti i Serbisë, Aleksandar] Vuçiq dhe [shefi i zyrës për Kosovën në qeverinë serbe, Petar] Petković", ka shkruar Sveçla në "Facebook". Ministri Sveçla shtoi se këto "banda kriminale po tentojnë ta destabilizojnë shtetin tonë". Edhe në të kaluarën Policia e Kosovës kishte realizuar operacione kundër drogës në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe. Në majin e vitit të kaluar policia kishte shkatërruar dy laboratorë droge në Izvor, afër kufirit me Serbinë, ku ishin gjetur edhe sasi të mëdha të bimëve narkotike, të llojit marijuanë. Po ashtu, në prill ishte shkatërruar një laborator droge në Zvečan dhe ishin arrestuar katër serbë.

## Seancat gjyqësore në Pallatin e Drejtësisë shtyhen për shkak të temperaturave të ulëta

Prishtinë, 12 shkurt - Temperaturat e ulëta që po mbizotërojnë dhe mosfunksionimi i ngrohjes në Pallatin e Drejtësisë kanë bërë që gjatë javës që lamë pas disa seanca gjyqësore të shtyhen. Situatë e njëjtë mund të përsëritet edhe në vazhdim

pasi funksionalizimi i ngrohjes në objektin, seli e shumicës së gjykatave të Republikës së Kosovës, nuk duket afër. Para pak ditësh është shtyrë edhe seanca në çështjen e njohur si "53 milionëshi", ku është i përfshirë ish-ministri

Pal Lekaj, pikërisht për shkak të ftohtit në sallën e Gjykatës Themelore të Prishtinës. Avokati i përfshirë në këtë rast, Musa Damati, e quan skandaloz mungesën e ngrohjes në objektin, ku qytetarët presin të marrin drejtësi.





## Mbi 33 000 viktima nga tërmetet, OKB-ja pret që numri të dyfishohet

Kombet e Bashkuara dënuan dështimin për t'i ndihmuar rajonet e Sirisë teksa paralajmëruan se numri i viktimave nga tërmetet në Turqi dhe Siri, që ka arritur në mbi 33 000, mund të dyfishohet. Dhjetëra mijëra punëtorë të shpëtimit po vazhdojnë operacionet për të gjetur të mbijetuar pavarësisht prej temperaturave të ulëta që kanë rënduar gjendjen e miliona personave që tani kanë nevojë për ndihmë

**ANKARA, 12 SHKURT** - Kombet e Bashkuara dënuan dështimin për t'i ndihmuar rajonet e Sirisë, teksa paralajmëruan se numri i viktimave nga tërmetet në Turqi dhe Siri, që ka arritur në mbi 33 000, mund të dyfishohet. "Deri më tani kemi parë dështim për t'i ndihmuar banorët në veriperëndim të Sirisë. Ata me të drejtë ndihen të braktisur. Ata po presin ndihmën ndërkombëtare që ende nuk ka ardhur", tha shefi për ndihmë i OKB-së, Martin Griffiths.

Ekipet e shpëtimit kanë nxjerrë të gjallë një bebe shtatëmuajshe dhe një vajzë adoleshente nga rrënojat të dielën, teksa Griffiths ka vizituar Turqinë dhe më pas Sirinë më 12 shkurt.

Dhjetëra mijëra punëtorë të shpëtimit po vazhdojnë operacionet për të gjetur të mbijetuar pavarësisht prej temperaturave të ulëta që kanë rënduar gjendjen e miliona

personave që tani kanë nevojë për ndihmë.

Për shkaqe sigurie, disa operacione të ndihmës janë pezulluar dhe dhjetëra persona janë arrestuar për shkak të plaçkitjeve apo tentimit për t'i mashtruar viktimat pas tërmeteve në Turqi, ka raportuar media shtetërore.

Por, në gjithë këtë situatë të rënduar, ende po shpëtohen persona nga rrënojat. "A ka botë këtu?", pyeti 70-vjeçarja Menekse Tabak kur u nxor nga rrënojat në qytetin jugor të Kahramanmarshit - epiqendra e tërmetit prej 7.8 ballësh që goditi vendin të hënën.

Një bebe shtatëmuajshe, i quajtur Hamza, po ashtu u shpëtua në Hataj pas më shumë se 140 orë pas tërmeteve, ndërkaq EsmaSultan, 13 vjeçe, po ashtu u shpëtua në Gaziantep, raportoi media shtetërore.

Familjarët janë në garë kundër

kohës për t'i gjetur trupat e pajetë të më dashurve të tyre. "Ne kemi dëgjuar [autoritetet] se nuk do të mbajnë më gjatë trupat pas një periudhe të caktuar, ata kanë thënë se do t'i varrosin", tha Tuba Yolcu nga Kahramanmarsh.

### Njëzet e gjashtë milionë persona të prekur

Griffiths nga OKB, gjatë vizitës në Kahramanmarsh, tha se ai pret që numri i viktimave "të dyfishohet, apo edhe më shumë". "Shumë shpejt ekipet e kërkim-shpëtimit do t'ua lirojnë rrugën agjencive humanitare, detyra e të cilëve gjatë muajve të ardhshëm është që të përkujdesen për këtë numër kaq të madh të personave të prekur", tha ai përmes një video të postuar në "Twitter".

OKB-ja ka paralajmëruar se të paktën 870 000 persona kanë nevojë urgjente për shujta të ngruhta në mbarë Turqinë dhe Sirinë. Vetëm në Siri, deri në 5.3 milionë persona mund të mbesin të pastrehë.

Pothuajse 26 milionë persona janë prekur nga tërmetet, tha Organizata Botërore e Shëndetësisë. Ajo bëri një apel të ri të shtunën për 42.8 milionë

dollarë për t'u përballur me nevojat e menjëhershme shëndetësore.

OBSH-ja paralajmëroi se dhjetëra spitale janë dëmtuar.

Agjencia turke e fatkeqësive tha se mbi 32 000 persona nga organizatat turke po punojnë në përpjekjet e kërkim-shpëtimit. Po ashtu, në këtë shtet janë edhe 8 294 shpëtimtarë ndërkombëtarë. Restorantet po punojnë në qytetin e Gaziantepit së bashku me mijëra vullnetarë për t'i ndihmuar banorët që të ushqehen. "Kolegët tanë janë në situatë të keqe. Familjarët e tyre janë viktima dhe shtëpitë e tyre janë shkatërruar", tha Burhan Cagdas, pronar i një restoranti që po jep deri në 4 000 vakte ushqimore falas në ditë që kur ndodhi tragjedia.

Familjarët e tij po flenë në makina që nga e hëna në qytetin ku kanë vdekur të paktën 2 000 persona dhe dhjetëra mijëra të tjerë janë detyruar të flenë jashtë për shkak se shtëpitë e tyre nuk janë të sigurta.

Është raportuar për përplasje dhe zyra për të drejtat e njeriut e OKB-së të premten u bëri thirrje të gjitha palëve në zonat e prekura ku operojnë militantët kurdë dhe rebelët sirianë të lejojnë qasje në ndihmën

humanitare.

Ushtarët austriakë dhe punëtorët e shpëtimit gjermanë kanë pezulluar operacionet e tyre për disa orë të shtunën në Hataj, duke u thirrur në shkaqe sigurie për shkak të të shtënave midis grupeve lokale.

Partia e paligjshme e Punëtorëve të Kurdistanit, që konsiderohen grup terrorist nga Ankaraja dhe aleatët perëndimorë, ka njoftuar për një ndërprerje të përkohshme të luftimeve me qëllim që të mund të vazhdohen operacionet e kërkim-shpëtimit. Pikëkalimi kufitar midis Armenisë dhe Turqisë u hap të shtunën pas 35 vjetësh, me qëllim që kamionët me ushqime dhe ujë të mund të shkojnë në zonat e prekura nga tërmetet.

### Ndihmë mjekësore për Alepon

Dërgimi i ndihmës në Siri ka qenë i ngadalshëm. Ky shtet ka sistem të shkatërruar shëndetësor për shkak të luftës së gjatë civile dhe pjesë të shtetit ende mbeten nën kontrollin e rebelëve.

Shefi i OBSH-së, Adhanom Ghebreyesus, të shtunën dërgoi një avion me ndihmë dhe pajisje mjekësore në Alepon e prekur

# Osmani: Wagner po e ndihmon Serbinë të përgatisë një sulm të mundshëm ndaj Kosovës

PRISHTINË, 12 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka paralajmëruar se mercenarët e grupit rus Wagner po punojnë me paramilitarët serbë për të kontrabanduar armë dhe uniforma ushtarake pa stema në Kosovë.

Në një intervistë për "The Telegraph", Osmani tha se ky operacion ka për synim të krijojë terrenin për një sulm të mundshëm hibrid të Serbisë për të marrë nën kontroll territor të Kosovës. Këto përgatitje të pretenduara nga Serbia ngrenë paralele me aneksimin e Krimesë nga Rusia më 2014, kur ushtarët rusë, të veshur me uniforma pa stema, përgatitën rrugën për marrjen e gadishullit

ukrainas nga Moska. "Ata po sjellin armë dhe uniforma, por nuk janë pjesë e ushtrisë serbe. Serbia dëshiron t'i arrijë qëllimet e saj pa e quajtur operacion ushtarak", tha Osmani, duke mos ofruar dëshmi për këto pretendime. Sipas saj, objektivi i Serbisë është "ta përgatisë situatën për një aneksim të mundshëm jo përmes një operacioni tradicional ushtarak, por përmes një lloj sulmi hibrid".

Vitin e kaluar tensionet u rritën midis Kosovës dhe Serbisë për shkak të targave të makinave, duke nxitur disa serbë lokalë që për 20 ditë t'i bllokoi rrugët e veriut të banuar me shumicë serbe.

Situata u përkeqësua në dhje-

torin e kaluar, kur presidenti serb Aleksandar Vuçiq, kërkoi nga misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, që ta lejonte dërgimin e trupave serbe brenda Kosovës. Sipas Osmanit, Beogradi po vazhdon t'i rrisë tensionet në rajon në bashkëpunim me Wagnerin, që kohët e fundit ka nisur fushatën për rekrutimin e serbëve për luftën në Ukrainë.

Presidentja e Kosovës tha se strategjia e fshehur për kontrabandimin e armëve dhe municioneve është duke u zhvilluar në të paktën gjashtë muajt e fundit. Sipas Osmanit, kjo strategji ka synimin "e njëjtë" me atë që përdori presidenti rus Vladimir Putin, kur aneksoi paligjshëm Krimenë. "Nëse shikoni se çfarë

bëri Putini më 2014, është krejtësisht e njëjta. Fillimisht, ai instrumentalizoi rusët që jetonin atje, mandej ai krijoi operacione të rreme dhe më pas ai dërgoi këto grupe paramilitare. Ka të dhëna të qarta se grupet paramilitare serbe po planifikojnë dhe organizojnë këtë [së bashku me Wagnerin]. Sa ka qenë numri i tyre që ishin në kufi apo brenda [territorit të Kosovës] është diçka që ende po hetohet", tha presidentja Osmani.

Sipas të parës së shtetit të Kosovës, synimet janë krejtësisht agresive. "Ata hapin llogore dhe barrkada të stilit ushtarak, të llojeve që mund të përdoren për të luftuar", tha ajo.

Osmani tha se, pavarësisht prej

pranisë ushtarake të NATO-s në Kosovë përmes misionit të KFOR-it, nuk do të thotë se Serbia nuk do të tentojë të veprjë sikurse Rusia, që nisi pushimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022. "Nuk po them se ai [presidenti serb Aleksandar Vuçiq] do ta bëjë, por po them se duhet të jemi të gatshëm që ta parandalojmë një skenarë të tillë".

Zyrtarët e Kosovës edhe më herët kanë thënë se në veri të Kosovës mund të ketë përfshirje të personave që kanë lidhje direkte apo indirekte me mercenarët e Wagnerit. Kosova, po ashtu, e ka akuzuar Rusinë se po e nxit Serbinë që t'i rrisë tensionet me Kosovën. Moska i ka mohuar këto akuza të Prishtinës.



nga tërmetet.

Tedros pa nga afër zonat e prekura të qytetit dhe u takua me dy fëmijë që humbën prindërit e tyre nga tërmetet. "Nuk ka fjalë për ta shprehur dhimbjen nëpër të cilën ata po kalojnë", shkroi ai në "Twitter". Damasku tha se ka miratuar dërgimin e ndihmës humanitare në zonat e prekura nga tërmetet që janë jashtë kontrollit të tij, përkatësisht në provincën Idlib.

Konvojat me ndihma pritej që të arrijnë të dielën, por më vonë autoritetet, pa dhënë shpjegim, ndërprejnë këtë operacion.

Ministria e Transportit tha se 57 avionë me ndihmë kanë aterruar në Siri gjatë kësaj jave.

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, i bëri thirrje Këshillit të Sigurimit që ta autorizojë hapjen e një pikëkalimi të ri kufitar midis Turqisë dhe Sirisë në mënyrë që

të mund të dërgohen ndihma. Këshilli i Sigurimit do të takohet javën e ardhshme për të diskutuar për situatën në Siri.

Turqia tha se po punon që të hapë dy rrugë të reja që do të çonin në zonat në Siri, që janë nën kontrollin e rebelëve.

## Zemërimi i publikut

Ditët e mbushura me pikëllim dhe ankth ngadalë po

shndërrohen në zemërim lidhur me cilësinë e dobët të ndërtesave dhe për reagimin e qeverisë ndaj fatkeqësisë më të rëndë që ka goditur Turqinë në gati një shekull.

Zyrtarët kanë thënë se 12 141 ndërtesa ose janë shkatërruar ose janë dëmtuar rëndë nga tërmetet.

Policia turke të shtunën raportohet se ka arrestuar 12 persona, përfshirë edhe

kontraktorë, lidhur me shembjen e ndërtesave në provincat jugore të Gaziantepit dhe Sunliurfës.

Ndërkaq, më 12 shkurt u bë e ditur se autoritetet kanë lëshuar 113 urdhërarreste që lidhen me ndërtesat e shembura gjatë tërmeteve të fuqishme.

Zyrtarët dhe ekipet shëndetësore thanë se 29 605 persona kanë vdekur në Turqi dhe 3 574 në Siri. Deri më tani numri i viktimave të konfirmuara ka

## Gjykata Speciale, me prapaskenë të makinerisë mafioze serbe!

Shkruan: Sali BISLIMI

Programi i fundit në televizionin zviceran "Temps Present", i transmetuar në RTS të enjten, më 9 shkurt 2023, kumbon si rrëqethëse në rrafshin politik dhe juridik të Serbisë me gjykatën ndërkombëtare të Hagës, veçanërisht në lidhje me rrethanat e arrestimit të presidentit Hashim Thaçi.

Ky dokumentar precizon saktë dhe me paanshmëri na mëson se si është vepruar me kohë nga të infiltruarit serbë tek autoritetet politike përgjegjëse për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, përkatësisht "fabrikimin" e provave kundër presidentit Thaçi, atëherë në pushtet.

Në veçanti, nga dëshmia e agjentit "Sony", me emrin e supozuar del se kriminelët serbë ishin përgjegjës në përgatitjen e vrasjes së Dik Martit, ish-raportues i Këshillit të Evropës për t'ia faktuar



pastaj UÇK-së krimin, në veçanti presidentit, Hashim Thaçi.

I pyetur për këtë ngjarje Nikola Stojanović, këshilltar i kryeministrit serb, refuzoi t'u

përgjigjej pyetjeve të gazetarëve zviceranë, duke u strehuar pas fshehtësisë së hetimit, ndërsa pohoi se asnjë organizatë serbe nuk kishte kërkuar të kryente këtë atentat, i cili kundërshtoi

ashpër policinë federale zvicerane - Fedpol.

Kjo aferë e mjegullon dhe konfirmon se drejtësia ndërkombëtare ndaj presidentit Thaçi është e

njollosur me njëanshmëri, dhe lë dyshime të pariparueshëm për vërtetësinë e fakteve të pretenduara kundër tij.

Për këtë arsye dhe duke pasur parasysh seriozitetin e ngjarjeve të zbuluara në "Temps Present" konstatoi se procesi gjyqësor kundër Hashim Thaçit është i padrejtë dhe proces politik, dhe urgjentisht me këto fakte të reja duhet të rishqyrtohet aktakuza dhe të anulohet procesi gjyqësor menjëherë.

Në këtë program televizive zviceran sugjerohet dhe kuptohen të gjitha dhe gjithçka se si autoritetet serbe kanë ndërtuar dhe trafikuar provat kundër liderëve të UÇK-së.

Bëj apel gjyqtarëve për drejtësi se presidenti Thaçi është deklaruar i pafajshëm, dhe kontributi i tij është vetëm dhe vetëm për pavarësinë e vendit të tij. Kosovën e tij!

(Autori është 'Ambasador i Paqes' dhe drejtor i OJQ 'Zëri Perëndimor i Kosovës'. Jeton dhe vepron në Zvicër)

## Haxhiu: Prokuroria dhe gjyqësori do të çlirohen nga ata që i kanë kapur ndër vite

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka reaguar pas kritikave të opozitës rreth deklaratës së saj në gjykatë, ku në cilësinë e të akuzuarës i ka kërkuar prokurorit të dorëzohet në lidhje me rastin e hedhjes së gazit lotsjellës në kuvend para shtatë vjetësh. Ajo ka shkruar në "Facebook" se prokuroria dhe gjyqësori do të çlirohen nga ata që i kanë kapur ndër vite. "Pikërisht këta që sot bëjnë zhurmë pa përmbajtje, e mbajnë konferenca pa asnjë kuptim. Të njëjtët përmes

njerëzve në sistem jo rrallëherë kanë montuar procese politike të gjykimit ndaj lëvizjes dhe aktivistëve të saj", ka shkruar Haxhiu.

Ajo ka theksuar se veprimet politike për të cilat janë gjykuar kanë qenë përherë publike. "Sikurse deklaratat ime në cilësinë e të pandehurës në linjë me të drejtat e mia që njihen me legjislacionin në fuqi", ka shkruar Haxhiu.

Ajo ka theksuar se thirrja e saj e vazhdueshme është që prokurorët ta ushtrojnë

detyrën me profesionalizëm dhe të heqin dorë nga përndjekjet politike sikurse po bëhet tash e shtatë vjet. "Metodat njëzetvjeçare të opozitës për kërcënime dhe pazare nën tavolinë nuk gjenden në qeverisjen Kurti. Prandaj ka zëra të tillë që sulmojnë sepse brenda dy vjetëve të mandatit qeverisës kemi ndërmarrë nisma reformuese me qëllim të fuqizimit dhe kthimit të besimit qytetar në institucione", ka theksuar Haxhiu.



## Rama me familjen në Prizren: Të jep një kënaqësi të posaçme, njerëzit me energji ngado që i hedh sytë

PRIZREN, 12 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka zgjedhur të kalojë pak kohë në Kosovë. Së bashku me gruan dhe djalin, Rama të dielën u lajmërua nga Prizreni, duke publikuar një fotografi në "Facebook". "Prizreni të jep përherë një kënaqësi të posaçme; historia e shqiptaria bashkëjetojnë në ajrin që thith dhe njerëzit kanë një energji shumë të mirë ngado i hedh sytë", ka shkruar Rama.



## “Mashtrimet e mëdha” të qeverisë sipas LDK-së: Shtrenjtim 100 për qind të energjisë

PRISHTINË, 12 SHKURT - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka listuar disa nga mashtrimet me energji që, sipas saj, qeveria Kurti ua ka bërë qytetarëve.

Sipas partisë opozitare, qeveria Kurti ka mashtruar qytetarët për energji të lirë e të qëndrueshme. “Mashtruan për energji të lirë. Mashtruan për

energji të qëndrueshme. Asnjë angazhim për të rritur kapacitetet gjeneruese”, thuhet në njoftimin e kësaj partie. LDK-ja ka theksuar se nga të

gjitha premtimet e kësaj qeverie për energji të qëndrueshme dhe të lirë, realiteti është shtrenjtim 100 % i energjisë.



## Kurti fton qytetarët të aplikojnë në konkurset e hapura në ndërmarrjet publike

PRISHTINË, 12 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka bërë thirrje qytetarëve që të aplikojnë në konkurset e hapura në ndërmarrjet publike. Ai i ka ftuar të aplikojnë gratë, personat me nevoja të veçanta dhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, “për t’i rikthyer ndërmarrjet tona publike në kontribuues të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies së gjithmbarshme”.

Më tutje, Kurti ka thënë se suksesi në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve publike varet sa nga vullneti aq edhe nga angazhimi. “Vullneti i institucioneve. Angazhimi i profesionistëve. Ne jemi të bindur se ndërmarrjet publike kanë

potencialin që të jenë motori i zhvillimit ekonomik ngaqë operojnë në sektorët kyç të ekonomisë si ai i energjetikës, minierave, komunikimeve postare e elektronike, transportit hekurudhor, i ujërave. Kjo na bën që të jemi të përkushtuar që në to të angazhohen profesionistë me aftësi dhe përgatitje të duhura krahas integritet personal. Andaj, i ftojme të gjithë, veçanërisht gratë, personat me nevoja të veçanta dhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që të aplikojnë në konkurset e hapura për të realizuar këtë potencial dhe për t’i rikthyer ndërmarrjet tona publike në kontribuues të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies së gjithmbarshme”, ka theksuar Kurti.



## Ambasadori Westerlund: Ka interes nga kompanitë suedeze që të vijnë në Kosovë

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ambasadori Jonas Westerlund, duke folur për marrëdhëniet ekonomike, ka thënë se ka interes nga kompanitë suedeze që të vijnë të investojnë në Kosovë. Në një intervistë për “Telegrafi”-n, ambasadori i Suedisë në Kosovë thekson se është momenti i duhur të hapet Oda Suedeze e Bizneseve. “Nëse keni qenë në ‘Albi Mall’, ‘H&M’ ka hapur dyqanin aty, gjithashtu kemi kompaninë ‘Lindex’ që do t’i hapë disa dyqane këtu në Kosovë. Ka interes nga kompanitë suedeze që të vijnë në Kosovë. Jam duke provuar që t’ua mbush mendjen kompanive suedeze që bëjnë procesimin e drurit, gjithashtu industrisë së mobileve dhe me këtë mendoj se mund të bëjmë shumë në këta dy sektorë”, thekson Westerlund.

Ai ka shtuar se hapja e Odës Suedeze të Bizneseve do të nxiste që kompanitë nga ky vend të investojnë në Kosovë.



“Unë mendoj se duhet të jenë disa organizata biznesore, si Oda Suedeze e Tregtisë, Oda Nordike e Bizneseve apo disa nga këto forma të shoqatave të biznesit, që mund të ndihmojnë dhe informojnë ndërmarrjet suedeze se si mund të hapin biznese në Kosovë. Është shumë e

rëndësishme. Shikojeni Gjermaninë për shembull, kemi shoqatat e biznesit që janë mjaft të suksesshme. Austria, po ashtu, e ka Odën e Tregtisë. Australia kohën e fundit ka hapur Odën e Tregtisë në Prishtinë. Shumë gjëra po ndodhin dhe mendoj se është momenti i duhur që të hapet

Oda Suedeze e Bizneseve apo Oda Nordike e Bizneseve së bashku me Ambasadën e Norvegjisë dhe Finlandës. Kjo do t’i nxishte më tepër bizneset suedeze”, shton Westerlund. Ambasadori suedez thotë se kompanitë e teknologjisë janë në kërkim të parterëve dhe, sipas tij, Kosova do të jetë vendi i

ardhshëm për këto biznese. “Kemi pasur bashkëpunim me shumë kompani në Ukrainë dhe pas agresionit rus ato kanë shprehur interesim të gjejnë vende të tjera në Evropë për kompanitë suedeze të IT-së që të fillojnë bashkëpunimin dhe unë mendoj që Kosova do të jetë vendi i ardhshëm pasi që është mjaft e avancuar në qasjen në internet dhe ekspertizë të IT-së”, thotë ambasadori suedez.

Westerlund ka treguar se Suedia është donatori i pestë më i madh në Kosovë që nga përfundimi i luftës më 1999. “Jemi shumë krenarë që jemi donatori i pestë më i madh në Kosovë dhe që kemi qenë këtu që nga përfundimi i luftës më 1999 dhe një nga sektorët që kemi qenë të fokusuar është zhvillimi ekonomik. Një program që aktualisht ne e kemi është mbështetja e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore me qëllim të mbështetjes së bizneseve duke garantuar kreditë”, tregon Westerlund.

## Ministri Murtati thotë se janë regjistruar 1 000 vende pune në platformën ‘Superpuna’

Prishtinë, 12 shkurt - Ministri i Financave, Hekuran Murati, me anë të njoftimi, ka bërë me dije se në javën e parë janë regjistruar 1 000 vende pune në

“Superpuna”. Sipas Muratit, të gjithë të rinjtë që janë në kërkim të një vendi pune kanë mundësinë të regjistrohen në këtë platformë. “Që në javën e

parë pas lansimit, kemi mbi 1 000 punëkërkues të regjistruar dhe verifikuar në platformën Superpuna! Të gjithë të rinjtë e moshës 18-25 vjeç që janë në

kërkim të një vendi pune kanë mundësinë të regjistrohen dhe të gjejnë një vend pune me pagë të garantuar nga shteti”, ka njoftuar Murati.



# Lufta në Ukrainë po ndryshon të gjitha ekuilibrat evropianë



**Nga Pierre HASKI**

Pyetje: E dini se cili shtet evropian do të ketë ushtrinë më të fuqishme gjatë viteve të ardhshme? Në kushte normale, përgjigja do të ishte Franca, e vetmja fuqi bërthamore që nga dalja e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian, aftësitë ushtarake të së cilës janë testuar në operacione të ndryshme jashtë vendit.

Por gjërat po ndryshojnë. Nëse lëmë mënjanë armët bërthamore, ushtria kryesore e Bashkimit Evropian do të jetë shumë shpejt ajo e Polonisë. Kjo është një nga pasojat e drejtpërdrejta të pushtimit rus të Ukrainës. Polonia, një vend afër zonës së konfliktit, po investon shumë në fushën e mbrojtjes.

Vitin e kaluar Varshava nënshkroi një kontratë gjigante për blerjen e armëve nga Koreja e Jugut: tanke (do të ketë 4 herë më shumë se Franca), artileri dhe avionë, për një shumë totale prej 15 miliardë eurosh. Muajin e kaluar, qeveria polake arriti me Francën një marrëveshjetjetër për blerjen e dy satelitëve vëzhgues, për shumën 500 milionë eurove.

Vendi i ish-traktatit të Varshavës, tani anëtar i NATO-s, dëshiron që të ketë një peshe më të madhe në çështjet evropiane, dhe këtë e dëshmon ky investim madhor në sektorin e mbrojtjes. Por kjo nuk është pasoja e vetme e luftës në Ukrainë.

Të gjitha ekuilibrat e brendshëm të BE-së po ndryshojnë me themel, edhe pse është ende herët të nxjerrim përfundime, duke pasur

parasysh se konflikti Rusi-Ukrainë po zgjat.

Pasojat e luftës janë veçanërisht delikate në Gjermani, një vend i tronditur që në fillim të konfliktit nga nevoja për ta vënë sërish në dyshim vetveten.

Në qendër të debatit janë varësia nga gazi rus, ngurrimi për t'i dërguar Ukrainës armët e saj, pikërisht në kohën kur ajo ka më shumë nevojë, dhe pasiguria aktuale mbi çështjen e furnizimit të Kievit me tanke të kalibrit të rëndë.

Ky "tërmet" gjeopolitik po shkakton një tension të dukshëm në lidhje me rolin e Gjermanisë. Berlioni nuk po i rishikon angazhimet tij evropiane. Por në këtë pikë janë thyer kaq shumë tabu, sa që koalicioni i kryesuar nga kancelari Olaf Sholz duket se e ka humbur orientimin e tij pavarësisht shpalljes së një

'Zeitenwende', një pikë kthese historike.

Të dielën në Paris u kremtua 60-vjetori i pajtimit franko-gjerman, në kuadër të të cilit u mbajt një mbledhje e përbashkët e 2 qeverive. Një takim që më herët ishte shtyrë për shkak të mungesës së konsensusit mbi shumë çështje.


Por jo vetëm Gjermania. Edhe Franca është në telashe. Secila në mënyrën e vet, si Franca ashtu edhe Gjermania panë shembjen e sigurive të tyre më 24 shkurt 2022, ditën e pushtimit rus të Ukrainës. Udhëheqja tradicionale e Evropës dështoi menjëherë, sepse nuk ishte gati për këtë luftë, ndërsa vendet e Frontit Lindor, shumë më të vëmendshme ndaj aktiviteteve të Moskës, e kuptuan shumë shpejt se çfarë ishte në lojë.

Pas një viti, pasojat politike të kësaj përçarjeje nuk janë kapërcyer ende. Të dielën Emanuel Makron mbajti një "fjalim të ri të Sorbonës", duke e ri-proponuar vizionin e tij evropian 5 vite pasi e prezantoi atë për herë të parë. Ndërkohë më 18 janar, ai nënshkroi një traktat miqësie me Spanjën, ndërsa Parisi dhe Berlioni po përpiqen që të jenë në të njëjtën linjë mbi Ukrainën dhe Evropën.

Këto manovra të mëdha politike, nxjerrin në pah përpjekjen për t'iu përshtatur botës së re të karakterizuar nga lufta, dhe mbi të gjitha për ta përgatitur Evropën për zhvillimet e ardhshme. Raportet e forcave kanë ndryshuar, dhe ato të së nesërme do të farkëtohen duke filluar nga sot. / "Francë Inter" – Bota.al



# Fluska ka plasur, dhe tani Big Tech po i dërgon të gjithë në shtëpi



Vitin e kaluar, kompanitë e mëdha të teknologjisë pushuan nga puna 154.186 njerëz. Kjo për të kompensuar punësimet e tepërta gjatë 2 viteve të pandemisë, dhe po ndodh në mënyra që shpeshherë shkelin kodin e punës Himanshu Verma, një inxhinier softuerësh nga India, u transferua në Kanada për të punuar për kompaninë Meta në fillim të nëntorit 2022. Vetëm 2 ditë më vonë ai u bë një nga 11.000 punonjësit e pushuar nga puna nga Mark Zuckerberg.

Mes të pushuarve ishte edhe Xiaohui Huang, një vajzë kineze e cila shkroi në LinkedIn se ka vetëm 4 muaj kohë për të gjetur një punë tjetër, që të mos e humbasë vizën e qëndrimit në SHBA. E njëjta histori edhe për Aaron Doran, irlandez dhe baba i një vaje, e cila ishte dikur vetëm disa muajshe, kur i ati u shkarkua nga puna në kohën e krizës së shkaktuar nga kolapsi i bankës Lehman Brothers.

Tre histori midis 154.186 të personave të pushuar nga puna vitin e kaluar (një shifër e llogaritur nga faqja e specializuar layof-fs.fyi) nga 1 mijë kompani të sektorit të teknologjisë.

Pak ditë para shkurtimeve të Zuckerberg, Elon Musk njoftoi në Twitter se do të përgjysmontestafin e tij.

CISCO ka parashikuar më shumë se 4 mijë pushime nga puna, Shopify dhe Snap & Stripenga 1 mijë. Më rezistentët, si kompania

Apple, janë kufizuar tek një ngrirje e punësimeve të reja. Ky vit nisi njëllorj: Amazon njoftoi shkarkimin e 18 mijë punonjësve të "tepërt", Alphabet/Google të 12 mijë njerëzve, Microsoft 10 mijë, Salesforce gati 8 mijë dhe Spotify rreth 600 punonjës.

Vala preku kryesisht SHBA-në, por nuk kurseu as Evropën dhe Italinë. Kompania Meta ka zgjedhur të pushojë 22 nga rreth 130 punonjës në Milano. Amazon ka hequr dorë nga një qendër e re logjistike që do të kishte punësuar rreth 100 njerëz në Cuneo. Kjo lëvizje prek 3.500 punonjësit e tjerë në Piemonte dhe 17.000 në të gjithë Italinë.

Në korrik 2022, aplikacioni gjerman i dërgesave postare Gorillas vendosi të largohej nga tregu italian duke lënë pa punë 540 persona. "Unë kisha një kontratë me një afat të caktuar, ashtu si 480 punëtorë të tjerë. Por bëja pjesë tek gjysma e atyre që kompania kishte marrë përsipër t'i punësonte në mënyrë të përhershme"- thotë Alex Deiana, 30 vjeç, një ish-operator magazine në Romë.

"Menaxheri organizoi një videokonferencë me të gjithë punonjësit. Ai na bëri me dije se kompania kishte filluar procedurën e eliminimit të vendeve të tepërta të punës, dhe se kontratat që skadonin nuk do të rinovoheshin"- shton ai.

Para largimit, punonjësit përjetuan javë të tëra pune me një ritëm të çmendur. "Kompania shiti me një

ulje çmimi prej 70 për qind të gjitha produkteve për të liruar magazinat. Porositëishin të shumta dhe në sasi të mëdha, ndërsa punëtorë kishte gjithnjë e më pak. Në fund disa nga punëtorët shpërndanë nëpër Romë me biçikletë pako që peshonin mbi 25 kilogramë"- tregon Deiana.

Sipas CISL, bashkimi sindikal më të madh në Itali, raste të tilla tregojnë "emergjencën e trajtimit serioz të problemeve në lidhje me punën në platformat dixhitale". Natyrisht, kompanitë e teknologjisë përballen me probleme që janë të ngjashme për të gjithë ekonominë: inflacion, pasiguri gjeopolitike, energji e shtrenjtë, vështirësi në furnizim.

Edhe kompanitë në sektorë të tjerë po shkurtojnë vendet e punës. Por ky është një rast i veçantë. Nëse për S&P 500, indeksi më i rëndësishëm i Wall Street-it ra me 19 për qind në vitin 2022, të ashtuquajturat teknologji të mëdha u paraqitën më keq se mesatarja. Kështu Apple dhe Microsoft humbën gati 30 për qind, Alphabet 40 për qind, Amazon thajse 50, dhe Meta 64 për qind.

Pushimet nga puna kompensuan pjesërisht punësimin e 2 viteve më intensive të pandemisë. Ndërsa njerëzit kaluan kryesisht në punën online, kompanitë e teknologjisë arkëtuuan nivele të larta të ardhurash dhe zgjeruan stafet. Por pati nga ata e që e tepruan. Kështu Zuckerberg e pranoi se e punësoi

rreth gjysmën e punonjësve të tij midis viteve 2020-2022.

Sipas Andrea Rangones, bashkëthemelues i Observatorëve të Inovacionit Dixhital të Universitetin Politeknik të Milanos, "ne nuk po përballemi aktualisht me fundin e një epoke". "Shumë kompani vazhdojnë të arkëtojnë fitime të mëdha. Ata që nuk kanë arritur ende një bilanc pozitiv ekonomik-financiar janë në vështirësi, dhe duhet të konsumojnë nga vetja për të ecur përpara. Tani që kostoja e parave është rritur, investitorët po i penalizojnë"- shton ai.

Në Silicon Valley, më optimistët mendojnë se vala e shkurtimeve nga puna do të krijojë një brez të ri startup-esh. Agjencia Reuters tregoi së fundmi historinë e Nic Szerman, një i ri 24-vjeçar, që pasi humbi punën në Meta, filloi të kërkonte fonde për kompaninë e tij të re të pagesave me bazë blockchain.

"Kurseva mbledhur rrogën e 4 muajve, dhe tani kam kohë të fokusohem mbi projektin tim"- thotë ai. Fondacioni "Day One Ventures" ka nisur një iniciativë për financimin e startup-eve me sloganin "Financoni, mos pushoni nga puna". Më shumë se 1 mijë kompani aplikuan për një nga 20 çeqet me vlerën 100.000 dollarë. Në fakt, shumë kompani të mëdha të teknologjisë kanë lindur në kohëra krizash. Kështu Microsoft u themelua në vitin 1975, në kulmin e stanjacionit

ekonomik në SHBA. LinkedIn në vitin 2002, pas plasjes së fluskës dot-com. Airbnb në vitin 2008, vetëm disa ditë para fillimit zyrtar të Recesionit të Madh.

"Sot në treg ka shumë talente. Por ata që largohen nga kompanitë e mëdha kanë paga që pak kompani të reja mund t'i përballojnë. Për më tepër, pandemia ka detyruar shumë njerëz të rishikojnë ekuilibrin midis jetës së tyre private dhe asaj profesionale. Por kjo gjë nuk merret aspak në konsideratë në Silicon Valley"- thotë Nicoletta Corrocher, profesore në Departamentin e Menaxhimit dhe Teknologjisë në Universitetin Bocconi në Milano, Itali.

"Kompanitë kanë punësuar në masë pa menduar shumë për të ardhmen. Dhe me të njëjtën lehtësi ato po i pushojnë nga puna punonjësit. Kjo nuk ndodh për shkak të një gabimi në planifikim, por për shkak të mungesës së konsideratës së punës"- thotë Ivana Pais, profesore e sociologjisë ekonomike në Universita Cattolica po në Milano. Ky vizion që pasqyrohet edhe në modalitetet: "Në epokën e dot-coms dihej se një menaxher i një kompanie italiane i thërriste në zyrë punonjësit dhe i largonte nga puna me formulën e Big Brother: "Ti je dominuar!". Ishte një skandal. Sot sjellja sipërfaqësore është e njëjtë, por nuk jemi më të indinjuar". / bota.al

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## Fitojnë Ballkani dhe Llapi, humbasin Drita dhe Prishtina

Kampionia në fuqi Ballkani dhe fituesja e Kupës, Llapi kanë startuar sezoni9n pranveror në elitë me fitore. Ndërsa me humbje këtë sezonin e nisën Drita dhe Prishtina. Ndeshja e vetme që përfundoi pa fitues ishte me Gjilanit dhe Ferizajt

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 12 SHKURT** - Ndeshjet e para në sezonin pranveror të Superligës së Kosovës në futboll janë zhvilluar në fundjavë. Pretendentët për titull kanë nisur në mënyrë jo të mirë, derisa Drita pësoi humbje në Mitrovicë nga Trepça '89 me rezultat 1-0. Golin e vetëm në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Riza Lushta" e shënoi Armend Gashi, në minutën e 12-të. Pas kësaj fitoreje Trepça'89 ngjitet në pozitën e shtatë, me 22 pikë,

derisa Drita tashmë zbret në pozitën e dytë, duke ngecur tri pikë me Ballkanin kryesues. Në këtë mënyrë trajneri Arsim Thaqi debuton në krye të Dritës me humbje. Fitore shumë të rëndësishme ka regjistruar edhe Dukagjini ndaj Prishtinës në Klinë (1-0). Mërgim Pefqeli shënoi autogol në minutën e 43-të, dhe ky rezultat ishte final. Pas këtyre tri pikë Dukagjini ka arritur në kuotën e 25 pikëve në pozitën e pestë, dy më pak se Prishtina e vendit të katërt. Të shtunën fitore kanë regjistruar Ballkani dhe Llapi. Ndërsa Gjilani luajti baras me Ferizaj (0-



0). Ballkani shënoi fitore ndaj Malishevës me rezultat 4-2. Sulmuesi i spikatur Albion Rrahmani realizoi tre gola, kurse një tjetër e shtoi Veton Tusha. Ndërsa golat për Malishevën i shënuan Ilir Mustafa dhe Drilon Hazrollaj. Me fitore sezonin

pranveror e nisi edhe Llapi, që e mposhti Drenicën, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan, me rezultat 1-0. Golin e fitores për skuadrën e Tahir Batatinës e realizoi Francisco Rivera, nga penalltia në minutën e 12-të.

SUPERLIGA	
Malisheva - Ballkani	2-4
Drenica - Llapi	0-1
Gjilani - Ferizaj	0-0
Trepça '89 - Drita	1-0
Dukagjini - Prishtina	1-0
Tabela	
1. Ballkani	41 pikë
2. Drita	38
3. Gjilani	28
4. Prishtina	27
5. Dukagjini	25
6. Llapi	23
7. Trepça '89	22
8. Drenica	20
9. Malisheva	19
10. Ferizaj	14

Ndërkaq, Gjilani u detyrua të pajtohet me një pikë në shtëpi, pasi nuk arriti të gjejë golin në duel me Ferizajn (0-0).

## Beteja' në Karagaçi i takon Pejës, Ylli rrëmben pozitën e parë

**PEJË, 12 SHKURT** - Peja ka fituar super derbin dhe klasiken e basketbollit të Kosovës ndaj Sigal Prishtinës në një duel dramatik dhe interesant me rezultat 74:72 (28:18, 19:18, 14:19, 13:17). Kjo ndeshje i takonte xhiros së 22-të në Prince Caffè Superligës. Bardhekaltrit e nisën ndeshjen me një seri prej 0:5, por pejanët u kundërpërgjigjen shpejt dhe më pas zhvillohet lojë e barabartë, por vendasit nuk u ndalën dhe që në çerekun e parë krijuan epërsi prej dhjetë pikësh, duke e fituar këtë pjesë 28:18. Kryeqytetasit u rikthyen në periudhën e dytë, ku ngushtuan shifrat në 30:27, por skuadra verdhezi sërish u shkëput duke krijuar epërsi deri në 13 pikë, 45:32, ndërsa pjesa e parë përfundon 47:36. Në periodën e tretë, Peja arriti të kishte epërsi deri në 14 pikë, 57:43, që ishte më e larta në ndeshje, sidoqoftë, prishtinasit u rikthyen sërish, ku rezultati pas 30 minutash ishte 61:55. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua dramë deri në fund, ku mysafirët afruan rezultatit në 74:72, e më pas Tate i vendasve humbi dy gjuajtja të lira, ndërsa në aksionin e fundit, Thomas i mysafirëve nuk shënoi dhe Peja iu rikthye fitoreve. Te Peja u dalluan Arti Hajdari me 14 pikë, Jalen Tate me 19 dhe David



Joseph me 18, ndërsa te Sigal Prishtina u dalluan Dardan Berisha me 22 pikë, gjashtë kërcime e gjashtë asistime dhe Derrick Wilson me 23 pikë e gjashtë kërcime. Tani Peja ka 15 fitore e shtatë humbje, kurse Sigal Prishtina 16 fitore e gjashtë humbje. Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Rahovecit me rezultat 72:66 (16:16, 16:19, 27:11, 13:20), në xhiron e 22-të të Prince Caffè Superligës. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë me epërsi prej shtatë pikësh 12:5, por Vreshtarët u rikthyen shpejt për të barazuar rezultatit, ndërsa çereku i parë përfundon 16:16. Në periudhën e dytë, mysafirët kishin epërsi të lehtë, por më pas u rikthyen vendasit, ku pjesa e parë përfundon 32:35. Perioda e tretë ishte vendimtare në këtë sfidë. Në këtë pjesë Ylli ishte bindshëm më i mirë, duke e fituar 27:11 dhe për të krijuar epërsi komode deri në përfundim të ndeshjes, ku përkundër përpjekjeve të rahoveasve fitoi 72:66. Te Ylli edhe kësaj radhe më i miri ishte Gëzim Morina me 19 pikë e shtatë kërcime, ndërsa te Rahoveci u dalluan me nga 13 pikë Gary Blackston dhe Jack Pagenkopf. Kampionët dalin në vendin e parë me 17 fitore e pesë humbje, ndërsa Vreshtarët mbesin në vendin e fundit me dy fitore e 20 humbje.



## Rahoveci arrin fitore të rëndësishme në Gjakovë

Gjakovë, 12 shkurt - Rahoveci ka shënuar fitore të rëndësishme në Gjakovë. Të dielën në kuadër të xhiros së 16-të të Superligës së Kosovës në hendboll, Rahoveci fitoi ndaj Vëllaznimit vendas me rezultat bindës, 37:28. "Vreshtarët" nisën fuqishëm ndeshjen dhe shpejt krijuan epërsi 7:2. Vëllaznimi ia doli të afrohet vetëm në dy gola, por jo edhe më shumë. Në pjesën e dytë epërsia e Rahovecit shkoi deri në dhjetë gola, 26:16, e më pas edhe në njëmbëdhjetë gola, 33:22. Në fund Rahoveci fitoi me 37:28. Marley Wallace shënoi 11 gola për Rahovecin. Dhjetë i kishte Alban Haziri. Florian Rexha e Labinot Kërleshi i shënuan nga 6 gola për Vëllaznimin. Fitorja e Rahovecit është me shumë rëndësi për të vazhduar në Superligën A.


## Barcelona nuk gabon ndaj Villarrealit

Villarreal, 12 shkurt - Barcelona po vazhdon me formën e mirë në La Liga, teksa sonte regjistroi edhe fitoren e gjashtë radhazi, duke vazhduar kështu edhe

me kryesimin në tabelë. Skuadra e drejtuar nga Xavi shënoi fitore të vështirë sonte, por të rëndësishme, në udhëtim kundër Villarrealit. Ndeshja, e cila i

takoi javës së 21-të, u mbyll me rezultatit 0-1. Golin e vetëm dhe të tri pikëve për Barçën e shënoi mesfushori spanjoll, Pedri, në minutën e 18-të. Barcelona pas kësaj

fitore ka 56 pikë në pozitën e parë, tani 11 pikë më shumë se Real Madridi, që ka një ndeshje më pak. Villarreali renditet i teti me 31 pikë.





Në bazë të nenit 21 paragrafi 21.4 e Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087, si dhe Plotesim Ndryshimi i Ligjit mbi NP Nr.04/L-111, si dhe Kodi Etikes dhe Qeverisjes Korporative, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi"SHA-Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me 09.02.2023, vendosi të rishpallë këtë:

### KONKURS Për plotësimin e pozitës:

#### Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë

I përgjegjjet: Bordit të Drejtorëve.

Vendi i Punës: Prishtinë

**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Mandati për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv është 3 vjeçar.

#### Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Të menaxhoj kompaninë në baza ditore në pajtim me aktet ligjore dhe politikën e kompanisë,
- Të zbatoj qëllimet strategjike dhe objektivat e kompanisë duke i dhënë drejtim lidhshëm drejt arritjes së misionit dhe vizionit të kompanisë,
- Mbështet punën e Bordit të Drejtorëve me anë të propozimeve lidhur me politikën dhe vendimet që do t'i merr Bordi;
- Është përgjegjës për shërbimet që ofron kompania duke mbikqyrë kualitetin e programit të përgaditjes së shërbimeve, marketingun dhe shitjen e këtyre shërbimeve,
- Propozon buxhetin vjetor për aprovim të Bordi i Drejtorëve, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme,
- Në mënyrë efektive menaxhon resurset njerëzore të kompanisë brenda politikave zyrtare të kompanisë dhe procedurave konform ligjeve në fuqi,
- Siguron që misioni dhe programi i Kompanisë dhe i shërbimeve të saj, të jenë në mënyrë të vazhdueshme dhe fuqishëm të prezantuar për të krijuar një pasqyrim pozitiv të kompanisë të palët e interesit,
- Mbikqyrë ngritjen e fondeve, planifikimin dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e burimeve të financimit, si dhe përgaditjen e strategjisë për të i'u qasur këtyre burimeve duke ofruar propozim për administrimin dhe dokumentimin e ngritjes së këtyre fondeve,
- Menaxhon politika dhe zbaton vendimet e Bordit në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

#### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të vecanta:

- të kenë diplome universitare nga fusha ekonomike, juridike, teknike, shoqerore ose të ngjajshme.
- të kenë përvojë profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues në insitucione shtetërore ose ndërmarrje publike
- të kenë integritet të lartë moral e profesional,
- të kenë aftësi të dëshmuara në udhëheqje ose menaxhim,
- njohja e gjuhëve të huaja do të ketë përparësi,
- të mos jenë të dënuar ose nën hetime.

Aplikacionit për pozitën e KE-se duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- CV-ne (Biografine),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Planin personal zhvillimor strategjik të ndërmarrjes për 3 vitet e ardhshme
- Letër motivimin,
- Deklaratën nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje, (e noterizuar)
- Certifikatën që nuk është nën hetime.

#### Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri bazike në programet e kompjuterit, përvojë 5 vjet në nivelin drejtues dhe në fusha që ndërlidhen me menaxhim të insitucioneve apo ndërmarrjeve publike, njohja e gjuhëve të huaja është e dëshiruar.

#### Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi i ri shpallur është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, respektivisht nga data 11.02.2023 deri me 27.03.2023.

**Procedura për aplikim:** Aplikacioni merret në Kompani, të njëjtit i bashkëngjiten dokumentet deklarata nën betim, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës, dëshminë nga trusti pensional, dëshminë për përvojën, dëshminë se nuk janë nën hetime apo te dënuar për vepër penale dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës, dokumentet të cilat pranohen pas afatit nuk shqyrtohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Pipina" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810847527.

- Sheqer Kamberi shpall të pavlefshme dëftesat vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- Edmond Jahjaga shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB-Prishtinë, të lëshuar në vitin 2006.

- Zana Haraqija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Dardane Qela nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Armira Arifi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12,13 dhe diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari"

- Jonida Lulzim Haxhiajdini nga Peja shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të edukimit pran universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me nr. 408

- Liki&Abi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811477589.

- Shahin Arifi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT : Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).

- Blerta Gjeloshi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni"

- Lutfi Hajra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani" ( ish Boris Kidric).

- Xhevdet Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha".

- Mentor Bunjkau B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:81036429.

- Famous Club sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810110114.

- Arbnor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e maturës te SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Berat Bajraktari shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Shefki Azemi shpalle te pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DTC me numër 366/18 Kursi Hidroinstalim-ujësjellës.

- Rafet Durmishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT" Arkitekt Sinani".

- Naser Hasani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e TVSH-se e numër 330043737.

- Mentor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM" Dr Xheladin Deda".

- Antigone Beka shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme " Dr. Xheladin Deda".

- Vëllezërit Hysa SH.P.K. Dega Kosove shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811324409.

- Sh.P.K Broja Market shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810359209.

- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.

- Granit Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Ora Travel SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811467168.

- Gabriell Prenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjminazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Nora Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl I te sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Jozef Tunprenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Don Shtjefen Kurti" Novosell e Epërme nga kl.I-V dhe VI-IX

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




## PASHTETË PULË

**MEKA**  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues